

22.11.23

selc. / Keshillit



1/2023
22.11.23
22.11.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË PUKË
Sheshi "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Pukë

Data 20.11.2023
Nr. Prot 7654

Për Dijeni: Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare
Rruga "Besa", nr.55, Njësia Administrative nr.8 Tiranë
Z. Aleksandër Nikollë Frroku
Shkozë, Pukë

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

I nderuar Z.Frroku,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 14.11.2023, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Pukë, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare, z. Aleksandër Nikollë Frroku.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr.817 datë 14.11.2023.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.11.2023

Nr: 817

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË PUKË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË "ALEANCA ARBNORE KOMBËTARE", Z. ALEKSANDER NIKOLLË FRROKU

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1311 prot., datë 20.7.2023, Këshilli i Bashkisë Pukë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Vitore Palë Frroku, propozuar nga subjekti politik "Partia Aleanca Arbnore Kombëtare".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare" për Këshillin e Bashkisë Pukë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 3, z. Aleksandër Nikollë Frroku.

Me shkresën nr. 7071 prot., datë 3.10.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pukë, z. Aleksander Nikollë Frroku, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 14.11.2023 Nr: 817
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare", z. Aleksander Nikollë Frroku".

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit "Partia Aleanca Arbnore Kombëtare", ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 34 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Aleksander Nikollë Frroku, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Aleksander Nikollë Frroku.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 11160/1 prot., datë 27.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Aleksander Nikollë Frroku, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 13558/1 prot., datë 24.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Aleksander Nikollë Frroku, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Aleksander Nikollë Frroku, në Këshillin e Bashkisë Pukë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Data: 14.11.2023 Nr: 817
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare", z. Aleksander Nikollë Frroku".

VENDOS:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore të "Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare", z. Aleksander Nikollë Frroku.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

